

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

12.09.2024

Ora, 11:09

RENDI I DITËS

“Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 depozituar nga Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues zotin Dhionisios Alfred Beleri”.

PJESËMARRJA :

- **KAS:** Z. Elvin Lako, z. Elvis Çefa, z. I. Rusmali, z. Koli Bele, z. Ledio Braho.
- **Stafi KQZ:** Znj. M. Koja, znj. P. Doçaj, z. E. Mema.
- **Parti Politike:** PBDNJ (z. Vangjel Dule)
- **Të tjerë:** Përfaqësuesja ligjore e zotit Beleri (znj. Klodjana Gjyzari)

KRIIK

Z. K. Bele: Përshëndetje! Çelim seancën e shqyrtimit në themel të kërkesës ankimore nr. 9, dt. 3.08.2024, me ankues Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut e përfaqësuar nga zoti Vangjel Dule, me objekt “Kundërshtimin e vendimit nr.169, dt. 5.07.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë zotit Alfred Petro Beleri, propozuar nga subjekti Koalicioni “Bashkë Fitojmë” për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore të 14 majit 2023. Gjithashtu relatojmë se kjo kërkesë ankimore shqyrtohet së bashku me kërkesën ankimore nr. 10 me ankues zotin Beleri, me të njejtin objekt. Në seancat paraprake në të dyja këto kërkesa është vendosur kalimi në seancë për shqyrtimin në themel, duke qenë se kërkesa nr. 9 ka qenë e para është bërë bashkimi i tyre dhe të dyja kërkesat shqyrtohen si një e vetme

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*


ku relator jam unë, Koli Bele sipas shortit të caktuar që në fillim. Relatohet gjithashtu prezenca e KAS-it me të pestë anëtarët. Kemi prezent dhe administratën e KQZ-së si gjithmonë, përfaqësuar nga drejtoresha juridike dhe pjestarë të tjerë të stafit të KQZ-së. Relatojmë se prezent kemi përfaqësues të ankuesit!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Po! Avokatia Klodjana Gjyzari, sipas deklaratës së dëguar dhe dorëzuar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, përpara Komisionerit, është edhe zgjedhja ime nga vetë personalisht kërkuesi Dhionisis Beleri. Po ashtu kam dorëzuar dhe një autorizim të nënshkruar prej tij gjatë shqyrtimit të çështjes përpara Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Numri im i licensës, në qoftë se është e nevojshme, të vijoj?

Z. K. Bele: Jo nuk është e nevojshme. Ndërkaq është depozituar edhe një kërkesë e drejtuar nga zoti Vangjel Dule me anë të së cilës paraqet kërkesën për të qenë palë në këtë shqyrtim. Çmujmë se, duke qenë se zoti Dule është gjithashtu ankues në cilësinë e kryetarit, ka të drejtën të jetë pjesë e këtij shqyrtimi. Besoj se dhe kolegët në këtë pikë nuk kanë ndonjë kundërshtim që në të dyja rastet është i legjitimuar që të jetë pjesë e këtij shqyrtimi. Në këtë fazë të parë, ka ndonjë kërkesë paraprake nga palët që ka të bëjë me trupën, apo kërkesa të tjera që mund të shtrohen?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Tani, kjo procedura administrative ka lidhje me një procedurë tjetër administrative që jemi në një proces civil në Gjykatën e Apekit Administrativ. Nga të dhënat që janë në faqen publike të Presidentit, rezulton që në përbërje të KAS-it është edhe zoti Ilirjan Rusmali, i cili rezulton që të jetë edhe këshilltar i Presidentit të Republikës. Një nga problemet që ka shkaktuar vendimi objekt-ankimi, ka qenë edhe ekzekutimi i tij i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

menjëhershëm dhe donim të shqyrtohej kryesisht nëse ka papajtueshmëri konflikt interesi zoti Ilirjan Rusmali në këtë procedurë duke qenë se mund të ketë dhënë opinione në lidhje me ekzekutimin, ose jo të këtij akti, në një organ tjetër administrativ i cili ka marrë vendim në lidhje me të njejtat pretendime.

Z. K. Bele: Nëse e kuptova drejt, ju kërkoni që ne ta shqyrtojmë kryesisht, apo po formuloni një kërkesë në të cilën ju duhet të...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Unë po ju ve në dijeni...

Z. K. Bele: Ne jemi në dijeni, ky është fakt. Nuk mendoj se në këtë fazë., zakonisht dhe në praktikën tonë dhe në procedurë, ju duhet të paraqesni një kërkesë nëse keni një të tillë. Pra, për ta ndarë qartësisht. Ju po paraqesni një kërkesë për përjashtimin e zotit Rusmali, apo thjesht na sillni në vëmendje këtë fakt që ju sapo thatë?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Unë mendova që ju nuk e dini që ne jemi në proces administrativ. Po duke qenë se ju thatë që e dini që ne jemi në proces administrativ, pohuat që e dini...

Z. K. Bele: Jo, thamë që e dimë për zotin Rusmali, nuk u shpreha për, por gjithësesi...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Dakord! Parashtrimi im ishte që t'u vija në dijeni që, dekreti i Presidentit të Republikës është objekt shqyrtimi administrativ. Objekt i kundërshtimit të atij dekreti ka qenë ekzekutimi i menjëhershëm i këtij vendimi që ne kemi pasur objekt gjykimi.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Këshilltari i Presidentit rezulton të jetë zoti Rusmali. Këtë informacion ua dhashë me mendimin që nuk e dinit. Tani, duke qenë se edhe sikur të mos e dinit, tani keni dijeni. Konstatohet se zoti Rusmali nuk është larguar me vullnet nga përbërja e këtij kolegji, atëherë unë kërkoj përjashtimin e tij, sepse dyshoj se ka konflikt interesi në rrethanat se si është zhvilluar procedura administrative për nxjerrjen e dekretit.

Z. K. Bele: Veç këtij parashtrimi, keni ndonjë citim, apo bazë ligjore, ku ne mund të drejtohem për të gjetur këtë papajtueshmëri të bazuar në ligj, sipas jush?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): KAS-i vepron sipas procedurave administrative dhe në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, neni 20 e vijues është e parashikuar konflikti i interesit. Unë mendova që ligji është i njohur për ju dhe nuk mendova se ishte e nevojshme ta citoja, por në Kodin e Procedurave Administrative është e parashikuar. Konflikti i interesit të anëtarëve të organit administrativ që shqyrtojnë mosmarrëveshjen. Duke qenë se rezulton të jetë i punësuar, apo nuk është i punësuar, nuk e di çfarë pozicioni ka, por rezulton të jetë këshilltar te Presidenti i Republikës dhe ka shprehur mendim në lidhje me një pjesë të objektit të shqyrtimit, ne kërkojmë që të deklarojë konfliktin e interesit dhe të largohet nga shqyrtimi i ankimit tonë. Në qoftë se më jepni edhe një...

Z. K. Bele: Edhe një pyetje në vazhdim të kësaj. Ju shprehët neni 20 e vijues. Na cituat një bazë ligjore e cila para kësaj trupe *quazi* gjyqësore, si para çdo trupe tjetër është shqyrtimi, është detyrimi i palës të arësyetojë për aq sa e di dhe sa ka mundësi në dijeni të ligjit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Neni 30.

Z. K. Bele: Dakord, neni 30. Ju thatë ka dhënë mendim zoti Rusmali. Mund të na jepni një..., nga buron kjo e dhënë që ju thoni?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Ne kemi dyshimet tona që ka dhënë mendim, se ai është këshilltar i Presidentit të Republikës.

Z. K. Bele: Ju keni dyshime?! Në çfarë cilësie?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Që është këshilltar? Po është në faqen zyrtare të Presidentit, po nuk e di...

Z. K. Bele: Dakord, pra kaq! Keni dyshime se ka dhënë mendim?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Po!

Z. K. Bele: Dakord! Kanë pyetje kolegët?

Z. I. Rusmali: Kam unë pyetje!

Z. K. Bele: Po!

Z. I. Rusmali: Ju jeni në proces gjyqësor thatë, në gjykatë, lidhur me dekretin e Presidentit?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Po!

Z. I. Rusmali: Objekti i kontestimit tuaj është ekzekutimi i menjëhershëm..,

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Ndër të tjera.

Z. I. Rusmali: Ndër të tjera. Ju në këtë seancë, evidentoni si të rëndësishëm faktin që Presidenti ka bërë ekzekutimin e menjëhershëm të këtij vendimi.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Po.

Z. I. Rusmali: Në kërkesën që keni sot, keni pretendime lidhur me ekzekutimin e këtij vendimi?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Në kërkesën që ne kemi sot, ne kemi pretendime për kompetencën, juridiksionin diskrecionin e Komisionerit...

Z. I. Rusmali: Por jo për ekzekutimin...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Por pasi u muar vendimi i Komisionerit, në të njejtën datë, disa orë më vonë, Presidenti i Republikës, nxori dekretin. Pasi nxorri dekretin, Presidenti i Republikës ka dhënë një prononcim për shtyp për “Zërin e Amerikës” në të cilin thotë “Shqyrtimi nëse është i ekzekutueshëm, apo jo vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, i

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

përket organeve përkatëse dhe do të shqyrtohet po nga organet përkatëse, gjykatat e të tjerë”. Në këto kushte duke qenë se ka një prononcim të tillë pra, është shqyrtuar pranë Presidentit të Republikës çështja e ekzekutimit të menjëhershëm, ose jo të vendimit të Komisionerit, atëherë, unë dyshoj që ju në cilësinë e këshilltarit, duke qenë se këshilltari normalisht juridik, këtë cilësi ka, të japë konsulenca juridike, mund t’i keni dhënë. Kjo është në ndërgjegjen e gjithësecilit. Unë thashë “mund”, prandaj nuk thashë keni dhënë, sepse këtë e dini ju më mirë se sa ne. Unë kam dyshimet e mia dhe jam e detyruar në përgjigje të interesave të atij që përfaqësoj, ta parashtroj këtë pretendim.

Z. I. Rusmali: Fakti që unë nuk po lëviz nga vendi, pavarësisht se kjo është në ndërgjegjen e gjithësecilit, a nuk ju bën të mendoni, jo të dyshoni, por të mendoni që unë s’kam lidhje me procedurën që ka ndodhur atje?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Me fal, zoti Rusmali, unë mendoj atë që mendon klienti dhe shfaq atë që mendon klienti dhe unë nuk e di se çfarë dini ju në lidhje me gjykimin tonë administrativ. Prandaj unë ju bëra me dije më parë gjykimin administrativ. Tani që ju pohoni që ju e dini, unë...

Z. I. Rusmali: Jo, jo, jo, unë mund të pohoj të kundërtën. Unë mund të pohoj këtu...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Unë nuk e di se çfarë keni ju në kokë, as ju nuk e dini...

Z. I. Rusmali: Unë nuk pohoj gjëra që ti mi vë në gojë. Unë mund të pohoj këtu që “unë nuk e di fare, që ju jeni në proces administrativ”, sepse nuk është çështje e imja.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Nuk është në sferën e punëve që unë bëj, se unë kompetenca atje nuk kam. Kështu që këtë mund ta pohoj. Nuk e dija, e mora vesh prej jush që ju jeni në proces administrativ për atë çështje. Tani që të kem dhe unë qartësinë e palëkundur, mund të më jepni referencën ke ai neni 30 që më vendos mua në konflikt interesi? Cili është shkaku ligjor që do të më vendoste, përtej dyshimeve që ju keni? Shkaku ligjor kush do të ishte që më vendos mua në konflikt interesi?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Unë mendoj sipas nenit 30, ju mund të...

Z. I. Rusmali: Lexojeni ju lutem, lexojeni!


Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Po të më lini deri në fund, mbase do të ...

Z. I. Rusmali: Dakord!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Sipas nenit 30 të Kodi i Prcedurave Administrive, “Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në raste se: ka qenë si ekspert, këshilltar, përfaqësues, apo avokat privat në çështjen në shqyrtim”, pika “ç”.

Z. I. Rusmali: Kjo lidhet me mua?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Të mbaroj pak të lutem?

Z. I. Rusmali: Jo, ti ndajmë një nga një se bëhet rrëmujë. Kjo lidhet me mua? Është ky rasti im?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Unë e kisha në formën e kërkesës. Ju rrëzojeni!

Z. I. Rusmali: Jo, të lutem! Ma shpjegoni! Më sqaroni ligjin! Kjo pikë që ju referuat avokat këshilltar, ekspert privat...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Këshilltar!

Z. I. Rusmali: Avokat këshilltar, ekspert privat...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Jo, jo, avokati është në fund! Është këshilltar, ose avokat. Ju...

Z. I. Rusmali: Lexojeni dhe njëherë nga e para!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Më falni, ju e keni kodin, ta lexojmë në të njejtën kohë, se mbase po ta lexojmë në të njejtën kohë...

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. I. Rusmali: Madalena të lutem, mund të na e lexosh këtë pikë të nenit. Duhet ta lexojmë që të ketë transparencë për publikun, ta lexojmë gjënë!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Ligji është i njohur për publikun, unë nuk kam problem ta lexoj.

Z. L. Braho: Po e lexoj unë, “Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur, germa “ç” Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjal ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim”.

Z. I. Rusmali: Në këtë çështje në shqyrtim, në çfarë pozicioni jam unë, përveç faktit që jam vetëm anëtar i KAS-it? Në këtë çështje që kemi?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Me falni, po përpiqeni të më mbushni mendjen të heq dorë nga kërkesa se nuk po e kuptoj diskutimin?

Z. I. Rusmali: Jo, po ju pyes që të kuptoj kërkesën.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Unë bëra kërkesën, ju shprehuni me vendim. Kundër vendimit lejohet ankim bashkë me vendimin përfundimtar. Nuk e kuptova diskutimin. Në qoftë se ju po përpiqeni të më mbushni mendjen që unë të heq dorë nga kërkesa, unë nuk heq dorë nga kërkesa. Vazhdojmë procedurën...

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. I. Rusmali: Jo, jo mos hiqni dorë, ju ta mbani kërkesën. Çështja është që ne duhet të kuptojmë bazën ligjore të kërkesës.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Bazën ligjore unë e citova, ju shprehuni, nuk po kuptoj pse po vazhdojmë të zgjatemi.

Z. I. Rusmali: Është shkronja “ç”?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Po.

Z. I. Rusmali: Dakord!

Z. K. Bele: Nëse nuk ka pyetje tjetër nga kolegët, për procedurë, ne po tërhiqemi për vendim. Do t’ju njoftojmë shumë shpejt besoj punë minutash.

Rifillon seanca


Ora 11:31

Z. K. Bele: Riçelim seancën. KAS pasi e diskutoi çështjen vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës si të pabazuar në ligj dhe në prova.

Në këtë fazë vazhdojmë me shqyrtimin e kërkesës. Pala ankuese fillimisht zoti Dule dhe pastaj në vijim përfaqësuesja e ankuesit zotit Beleri. Ju lutem shkurtimisht çfarë keni për të thënë përveçse ne i kemi me shkrim, sigurisht që të bëni parashtrimet tuaja në lidhje me çfarë kërkon nga KAS.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. Vangjel Dule, kryetar i PBDNJ: Që të respektojmë dhe kërkesën tuaj që t'i biem shkurtimisht, përfaqësuesja ligjore do t'i paraqesë argumentat për të dy palët, faleminderit!

Z. K. Bele: Të lutem!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri):
Faleminderit! Objekt i shqyrtimit si] e kemi parashtruar është vendimi nr. 69, datë 5.07.2024 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Në vlerësimin tonë ky vendim ka cënuar disa prej parimeve të Kodit të Procedurave Administrative të cilat sipas nenit 12, pika 5 të Kodit Zgjedhor gjejnë zbatim edhe në veprimtarinë e KQZ-së. Siç kemi relatuar, të dyja palët legjitimohen të kundërshtojnë vendimin nr. 69, datë 5.07.2024 për arësyet që ne i kemi parashtruar në ankim. Së pari, Partia Bashkimi Për të Drejtat e Njeriut ka qenë pjesë e Koalicionit “Bashkë Fitojmë”. Shtetasi Dhionisios (Alfred) Petro Beleri ka qenë kandidat për kryetar bashkie dhe me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023 të KSHZ i është dhënë dhe mandati pas konfirmimit të rezultatit zgjedhor të zgjedhjeve të datës 14 maj. Siç edhe duket nga përmbajtja e vendimit nr. 69 që është dhe objekt ankimi emri i shtetasit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, ka qenë në shqyrtim. Pra, të drejtat e tij kanë qenë në shqyrtim, pra të dyja palët gëzojnë legjitimitet aktiv për të kundërshtuar vendimin nr. 69. Përveç të tjerave ka qenë dhe palë në procedurën administrative para Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, gjë që është një arsye tjetër procedurale për legjitimimin e tyre. Në lidhje me shkaqet e ankimit, siç është debatuar dhe përpara Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe siç ka rezultuar, KQZ ka filluar një procedurë administrative, jo kryesisht, por bazuar në kërkesën e shtetasit zotit Eugen Likaj. Nëpërmjet objektit të kësaj kërkesë, kërkohet konstatimi i përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit të


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Bashkisë Himarë, zotit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri. Ka rezultuar nga procedura administrative, ndryshe nga kërkesa, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vendosur në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin vendim, bazuar në një kërkesë me këtë objekt që unë citova. Përfundimisht Komisioneri ka vendosur dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit edhe konstatimin e pavlefshmërisë së tij. Pra, në të njëjtën kohë është shprehur për dy gjëra të cilat nuk kanë lidhje me njëra-tjetrën. Së pari, pra është *nonsens* vendimarrja. Së dyti, për sa i përket procedurës administrative. Ne kemi kontestuar edhe përpara KSHZ që jo vetëm shtetasi Eugen Likaj nuk ka kompetencë të vendosë në lëvizje KSHZ për të shqyrtuar vlefshmërinë e mandatit të shtetasit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, por as KSHZ nuk e ka kompetencën që kryesisht të verifikojë vlefshmërinë e mandatit të zotit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri. Argumentat tanë mbështeten në shkaqet që kemi paraqitur edhe përpara Komisionerit, por në mënyrë të hollësishme i kemi parashtruar dhe në shkaqet e ankimit. Bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 139/2015, që është ligji “Për Qeverisjen Vendore”, parashikohen rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit të bashkisë dhe këto raste janë taksative, nuk lënë shteg interpretimi. Nuk thuhet në ligj, dhe për raste të tjera. Kjo ka dhe një arsye logjike pse e ka vendosur ligji. Mandati i kryetarit të bashkisë është mandat kushtetues dhe për mandatet kushtetuese shkaqet e përfundimit të tij duhet të jenë të parashikuara me ligj. Nuk mund t’i lihen në diskrecion, as një organi tjetër të vendosë nëse janë, apo raste të tjera për të parashikuar ndërprerjen e mandatit. Po të shihet neni 61 i ligjit 139/2015, rastet e përfundimit të parakohshëm kanë të bëjnë me rrethana objektive të cilat konstatohen si pazotësia e kryetarit të bashkisë për të ushtruar detyrën, për shkak të vdekjes, humbjes së zotësisë për të vepruar, apo rrethana subjektive prej tij, refuzimi i kryetarit të zgjedhur të kryejë betimin, mosbanimi në të njëjtën bashki ku është zgjedhur kryetar, kandidon për deputet, jep dorëheqjen, apo shkarkohet nga Këshilli


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

i Ministrave sipas nenit 62 të këtij ligj. Në të gjitha këto raste, procedura nuk kalon asnjëherë nga KQZ, por këshilli bashkiak (neni 61/3) njofton prefektin, i cili nga ana e vet njofton Këshillin e Ministrave, i cili njofton Presidentin, që zbaton Kodin Zgjedhor. Pra, KQZ është hallka e fundit pas Presidentit, për efekt të zbatimit të Kodit Zgjedhor. Pra, është për efekt të organizimit të zgjedhjeve në rast se Presidenti pranon kërkesën për ndërprerjen e mandatit. Në këtë dispozitë, e cila është e vetmja që parashikon në të gjitha ligjet që janë në Republikën e Shqipërisë, “përfundimin e parakohshëm të mandatit” të kryetarit të bashkisë, nuk parashikohet rasti i dënimit me vendim gjyqësor të formës së prerë si rast i përfundimit të parakohshëm të mandatit dhe nuk parashikohet që kërkesa mund të bëhet nga ndonjë shtetas në KQZ, si dhe nuk parashikohet që KQZ të ketë ndonjë kompetencë për të marrë ndonjë vendim në këto raste. Në pjesën arsyetuese të aktit administrativ objekt-gjykimi, Komisioneri nuk shprehet dhe nuk ka dhënë asnjë konsideratë fakti apo ligji në lidhje me kërkesës e paraqitur e cila e ka vënë në lëvizje, që ka pasur për objekt përfundimin e parakohshëm të mandatit. Pavarësisht parashikimeve të tilla ligjore të cilat nuk parashikojnë ndonjë detyrë apo funksion a rol të KQZ në rastet e përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit të bashkisë, pavarësisht se në pjesën arsyetuese Komisioneri nuk ka dhënë asnjë konsideratë, pra nuk e ka arësyetuar, as objektin e kërkesës, as ligjin e zbatueshëm, në pjesën urdhëruese të të njëjtit vendim shprehet “përfundimin e parakohshëm të mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë. Bazuar në sa më lart, vendimi i Komisionerit për përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të bashkisë Himarë, është marrë në mungesë të kompetencave që ligji, Kodi Zgjedhor, apo ndonjë ligj tjetër ka parashikuar për KQZ-në. Rezulton gjithashtu se me të njëjtën kërkesë, e cila kishte për objekt vetëm përfundimin e parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë dhe pa vendosur nisjen e ndonjë procedure kryesisht, Komisioneri ka vendosur në pjesën

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*


urdhëruese të vendimit, pavlefshmërinë e mandatit, bazuar në nenin 10/1 germa “ç” të ligjit nr. 138/2015. Kjo vendimmarrje në këtë pjesë është në kundërshtim me procedurën administrative të parashikuar në ligjin nr. 138/2015, për mënyrën e ushtrimit të kompetencës për verifikimin e vërtetësisë së të dhënave të formularëve të vetdeklarimit prej KQZ-së. Kërkesa e shtetasit Eugen Likaj, së pari, në qoftë se Komisioneri do të vendoste që do të fillonte një procedurë administrative, së pari bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, duhet të verifikonte që kjo kërkesë a ishte e aftë që ta vinte në lëvizje Komisionerin. Kërkesa e këtij shtetasi nuk përmbushte kërkesat minimalë. Ne kemi marrë një kopje pasi u shpall vendimi, gjatë seancës dëgjimore përpara Komisionerit na është paraqitur dhe kopja e kërkesës. Ndërsa pasi kemi marrë vendimin kemi marrë dhe një kopje të letërnjoftimit të këtij shtetasi. Ndërkohë që kjo shkresë, kopja e letërnjoftimit, nuk ka qenë në momentin që Komisioneri ka shqyrtuar kërkesën. Pasi ne e kemi pretenduar që kjo kërkesë, përveçse ishte absurde, nuk dihej që ky shtetas ekzistonte, apo nuk ekzistonte, ishte gjallë, kishte zotësi për të vepruar, ku jetonte, ku votonte.., sepse kërkesës i mungonte.., kishte vetëm kërkues Eugen Likaj, pa emër mamaje, babai, datëlindje, vendlindje. Pra, lementët minimalë të identifikimit të këtij shtetasi. Nuk kishte rrethana që Komisioneri të krijonte bindje që ky shtetas ekzistonte fizikisht, ose kishte aftësi juridike për të kuptuar se çfarë veprimesh po kryente. Duke qenë se ky shtetas nuk është paraqitur personalisht, as përpara Komisionerit, të paktën sipas procedurës. Unë i referohem vetëm akteve që kemi marrë nga Komisioneri. Pasi ngritëm këtë pretendim te Komisioneri bashkëngjitur me aktet, na u vu në dispozicion kopja e letërnjoftimit të këtij shtetasi. Por, dhe në vendimin e Komisionerit nuk thuhet është votues i Bashkisë Himarë ky shtetas? Gjithsesi sipas nenit 10 që është përdorur si bazë ligjore nga Komisioneri, janë përcaktuar subjektet që vënë në lëvizje Komisionerin për verifikimin e vërtetësisë së mandatit. Një

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

shtetas nuk është në rastet të cilat mund të vendosë në lëvizje Komisionerin. Pra, përveçse Komisioneri sipas nenit 44 të Kodit të Procedurave Administrative nuk ka verifikuar nëse kërkesa i përmbushte këto kritere për të vënë në lëvizje një organ administrativ, nuk ka verifikuar as kriteret thelbësore, përmbajtësore të kësaj kërkesë, sipas nenit 10, të ligjit 138/2015, sipas së cilës... pra sipas nenit 10 dhe 7 të ligjit, shtetasi që mund të vendosë në lëvizje Komisionerin që ai të marrë vendim sipas nenit 10 mund të jetë vetëm Kryeministri, Kryetari i Kuvendit, ose 500 votues. Në rastin konkret, me dijenitë tona, Eugen Likaj nuk është as Kryeministër, as Kryetar i Kuvendit, nuk përfaqëson as 500 votues dhe nuk e dimë a është votues edhe vetë i Bashkisë Himarë. Gjithashtu kërkesa e tij nuk përmban interesin e tij në lidhje me këtë procedurë administrative. Jo çdo shtetas mund t'i drejtohet një organi administrativ për të filluar një procedurë administrative sipas ligjit, por vetëm ata shtetas që kanë cilësitë që parashikon ligji. Në këtë rast Komisioneri duhet të kishte verifikuar kriteret formalë të kërkesës, nëse ky shtetas kishte zotësi për të vendosur në lëvizje një organ administrativ dhe kriteret përmbajtësore të saj sipas ligjit përkatës 138/2015. Gjithashtu, vlen për t'u theksuar se sipas ligjit nr. 138/2015 Komisioneri verifikon kushtet e zgjedhshmërisë vetëm mbi bazën e të dhënave të formularëve të plotësuar nga subjektet pjesëmarrës në zgjedhje. Ky verifikim ka një procedurë të caktuar që bëhet duke ia dërguar Prokurorisë së Përgjithshme kërkesën për verifikim të thelluar dhe Prokuroria e Përgjithshme rezultatet e verifikimit ia njofton Komisionerit. Rezulton se kjo procedurë për shtetasin Dhionisios Alfred Beleri është kryer. Me vendimin nr. 324 ka filluar verifikimi i thelluar i të dhënave të formularit për kandidatin Dhionisios Alfred Beleri, ky vendim është i datës 12.04.2023. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka vijuar më tej me procedurën administrative. Interpretimi i ligjit prej Komisionerit është bërë në mënyrë të shkëputur, duke moszbatuar parimet e përgjithshme të interpretimit të ligjeve, pasi


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

ka bazuar vendimmarrjen e tij vetëm mbi nenin 10. Ndërkohë që ligji ka dhe nenin 5, 6, 7 dhe 8. Sipas nenit 5 të ligjit nr. 138/2015, parashikohet detyrimi i subjekteve për të kryer vetëdeklarimin dhe më tej parashikohet organi kushtetues ku dorëzohet vetëdeklarimi, përcaktohet organi kush e boton vetëdeklarimin, gjithashtu dhe organet e parashikuara me ligj që kryejnë verifikimin e këtij formulari. Ligji parashikon se ndalimi për të kandiduar, zgjedhur apo ushtruar funksionin konstatohet duke u nisur nga të dhënat e formularëve të vetëdeklarimit, pra për fakte të cilat kanë ndodhur para kandidimit dhe nuk janë deklaruar në formularin përkatës të nxjerrë në zbatim të ligjit nr. 138/2015. Në lidhje me pengesa të tjera janë organe të tjera kushtetuese të cilat shqyrtojnë dhe marrin vendime. Në rast se një subjekt i cili ushtron funksion kushtetues, kryen një vepër penale gjatë ushtrimit të funksionit, atëherë nuk është Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve që merr vendim, por janë organe... psh në rastin e kryetarit të bashkisë, shkarkohet nga Këshilli i Ministrave. Komisioneri ka kryer interpretim të zgjeruar të ligjit nr. 138/2015, sipas tij është mbështetur tek neni 1 i këtij ligji. Neni 1 përcakton vetëm qëllimin e ligjit, janë dispozita të tjera të mëtejshme që përcaktojnë mënyrën se si ky qëllim realizohet. Siç është debatuar dhe në seancë para Komisionerit, ligji ndalon ushtrimin e funksioneve të përcaktuara, nga personat që nuk plotësojnë kriteret e pastërtisë së figurës sipas këtij ligji, por organet që e konstatojnë këtë papajtueshmëri janë të ndryshme, dhe procedurat janë të ndryshme në varësi të funksionit përkatës. Për sa i përket subjekteve që kanë qenë në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, atëherë i përkiste Komisionerit. Për sa i përket personave të tjerë, psh për gjykatësit e prokurorët ka kanë qenë organe të tjera respektive që vendosin ndërprerjen e mandatit. Arsyetimi i Komisionerit është kaq i hapur sa Komisioneri në të njëjtën mënyrë siç vendosi pavlefshmërinë e mandatit dhe në të njëjtën kohë ndërprerjen e parakohshme për ankuesin, mund të shkarkojë nesër bazuar në nenin 1, një gjyqtar

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

apo prokuror, sipas vlerësimit të tij neni 1 thotë që qëllimi i këtij ligji është që të pengojë ushtrimin e funksioneve publike kushtetuese të personave të cilët kanë pengesa që parashikon ky ligj. Më tej siç kam parashtruar dhe në ankim rezulton që vendimi është jo vetëm i paarsyetuar, por është dhe i paligjshëm, sipas neneve 99, 100 e 109 të Kodit të Procedurës Administrative. Vendimi nr. 69, që është objekt gjykimi, është rrjedhojë e zbatimit të diskrecionit në mënyrë jo të ligjshme. Bazuar në nenin 11 të Kodit të Procedurave Administrative diskrecioni ushtrohet në mënyrë të ligjshme, kur është i lejuar nga ligji. Pra, kur ligji ka të përcaktuar vetëm qëllimin dhe ka lënë kompetenca të gjera organit administrativ, për të arritur këtë qëllim, pasi ligji jo gjithmonë mund të parashikojë detajet. Në rastin e organeve kushtetuese ligji në rastin konkret ka përcaktuar në mënyrë taksative dhe detajet, pasi nuk mund të ngrihet një organ tjetër, i cili nuk është kushtetues, por mund të jetë i parashikuar në Kushtetutë dhe të verë në diskutim legjitimitimin e një organi të tillë, siç është në rastin konkret kryetari i bashkisë. Komisioneri në vendim ka ngritur pyetje, përgjigje, të cilat..., nuk i takojnë atij as të ngrejë pyetje, as të bëjë përgjigje, sepse jo të gjitha çështjet që rezultojnë nga momenti i kandidimit deri në momentin e përfundimit të mandatit i përkasin Komisionerit, apo KQZ për t'i zgjidhur, por janë dhe institucione të tjera. Komisioneri nuk mund të marrë dhe të ushtrojë kompetenca të organeve të tjera. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka cënuar nenin 4 të Kodit të Procedurave Administrative pikërisht në lidhje me mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe ushtrimin e diskrecionit të tij. Rezulton që i njëjti organ administrativ Komisioneri, ka dhënë dy vendime, për të njëjtin objekt. Me vendimin nr. 611 datë 25.05.2023 Komisioneri ka vlerësuar të ligjshëm mandatin e kryetarit të Bashkisë Himarë për zotin Dhionisios Alfred Beleri, vendim i cili për shkak të mungesës së ankimit nga palët është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm. Pra, vendimin nr. 611, datë 25.05.2023 nuk rezulton të jetë ankimuar asnjëherë,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

aktualisht. Rezulton që në vendimin nr. 69 datë 05.07.2024, Komisioneri ka vendosur pavlefshmërinë e mandatit, pa u shprehur në lidhje me këtë vendim, për të cilin nuk mund të shprehej normalisht se nuk kishte ankim, nuk ishte në kompetencën e tij. Nuk ishte më objekt shqyrtimi, i kishte kaluar afati i ankimit të këtij vendimi. Ndërkohë vendimi i dytë, vjen në kundërshtim me një vendim tjetër të të njejtit organ, i cili është i formës së prerë dhe për më tepër i ekzekutueshëm. Kanë cituar disa praktika të Gjykatës Kushtetuese të cilat janë publike dhe njihen. Paligjshmëria e gjithë praktikës së Komisionerit u përmbledh në arësyetimin e tij me gojë në seancë, i cili nuk gjen pasqyrim në fakt në vendim, por në qoftë se ju do të merrni audion e asaj seance do t'ju rezultojë kjo që unë kam shkruar dhe në ankim. Zoti Celibashi, në seancë publike duke arësyetuar vendimin tha “Kjo situatë është situatë e njejtë me një person i cili kërkon të hyjë në një “club”. Lejohet të hyjë në “club”, por në qoftë se ti je sherrëxhi, atëherë ti do të dalësh nga “clubi”, sepse ti duhet ti bindesh rregullave të “clubit”. Pra, me arësyetimin e tij që unë e përmbledha, por ishte pak më i gjerë, zoti Celibashi krahasoi Shqipërinë me një “club” privat. Zotin Beleri me një person që nuk i bindej rregullave të “clubit” privat dhe zoti Celibashi kishte marrë përsipër të zgjidhte pikërisht këtë siklet që kishte pronari i “clubit” privat dhe të nxirrte zotin Beleri nga “clubi” privat i dikujt. Ky ishte arsyeimi i zotit Celibashi në seancë publike. Mund t'i referoheni audios në qoftë se unë tejkaloj ndonjë nga fjalët e thëna. Kjo përmbledhje të gjithë debatin dhe ishte pjesë e arësyetimit të vendimit. Ky diskutim i zotit Celibashi ishte në pjesën e arësyetimit të vendimit me të cilën ne nuk mund të debatonim më në lidhje me cilësinë, cili ishte “clubi”, që të merrnim sqarimet e mëvonëshme e të mëtejshme, sepse u mbyll scanca e nuk kishim më të drejtën e fjalës. Përfundimisht, në vlerësimin tonë nuk mund të ketë kundërshti më flagrante të dispozitave që rregullojnë kompetencën se veprimi në mungesën totale të saj, apo duke marrë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

kompetencat e organeve të tjera. Nuk mund të ketë shkelje më të rëndë të procedurës së veprimit mbi bazën e kërkesës së një subjekti të palegjitimuar (pra pa kërkesë), pa nisur një procedurë administrative kryesisht, pa respektuar asnjë të drejtë të subjektit të verifikuar, duke vepruar në kundërshtim me nenet 5 - 10 të ligjit nr. 138/2015 dhe duke u shprehur jashtë kufijve të kërkesës, mbi të cilën kishte nisur procedimi administrativ. Nuk mund të ketë shkelje më të rëndë të kërkesave të ligjit për formën e aktit administrativ, pasi mungon arsytimi ligjor i tij. Pjesa urdhëruese me pjesën arësytuese kanë një mospërputhje të theksuar. Pavlefshmëria absolute e aktit të kundërshtuar, siç po e vëmë në dukje dhe në këtë ankim, mund të konstatohet edhe kryesisht prej organit administrativ që merr në shqyrtim mjetet ankimore. Në këto kushte, për të bërë objekt të shqyrtimit të gjitha shkeljet ligjore të sipërpërmendura, ne përfundimisht kërkojmë rivendosjen e parimit të ligjshmërisë, bazuar në nenet 113 dhe 114 të Kodit të Procedurave Administrative dhe të marrim sqarim nëse Shqipëria ishte “clubi” privat i Kryeministrit, apo zotit Celibashi dhe kërkojmë: Anullimin e vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si një akt i paligjshëm, dhe zgjidhjen e pasojave të ardhura prej tij. Vlefshmërinë e mandatit të ankuesit, të verifikuar dhe legjitimuar me vendimin nr. 611, datë 25.05.2023 të KQZ, si dhe konstatimin e mungesës së rasteve ligjore të “përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë”, sipas dispozitivit të vendimit të kundërshtuar të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Z. K. Bele: Faleminderit! Unë po e nis nga fundi, kisha vetëm një pyetje lidhur me kërkimin tuaj final. Ju kërkoni anullimin e vendimit të Komisionerit, unë këtë e kuptoj, dhe zgjidhjen e pasojave të tij, vlefshmërinë e mandatit të ankuesit. Të lutem, nëse mund ta komentojmë pak më shumë? Nëse mund të ma shpjegoni më tej çfarë

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

kuptoni me zgjidhjen e pasojave? Si do ta bëjë organi ynë i KAS-it këtë pjesën e dytë të kërimit tuaj, vlefshmërinë e mandatit të ankuesit, verifikuar dhe me...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionis (Alfred) Beleri):
Konstatimin e vlefshmërisë së mandatit, sepse ai që është i vlefshëm, është i vlefshëm se kemi një vendim administrativ për atë punë që nuk e ka ankimuar asnjë subjekt. Nuk është kundërshtuar, nuk ka qenë objekt shqyrtimi as administrativ, as gjyqësor.

Z. K. Bele: Mirë, faleminderit!

Z. E. Çefa: Unë kam nja dy pyetje të shkurtra për përfaqësuesin e Komisionerit, për administratën.

Z. K. Bele: Në fakt ne kemi...

Z. E. Çefa: Dakord! Do të presim të bëjnë parashtrimet, në rregull, dakord!

Z. K. Bele: Kemi pasur dy praktika. Pyetje kur mbaron njëra palë dhe pastaj kur mbaron pala tjetër. Të dëgjojmë dhe KQZ-në...

Z. E. Çefa: Dakord, do t'i le për më vonë pasi të bëhen parashtrimet. A mund t'i bëj një pyetje zonjës përfaqësuese të subjektit?

Z. K. Bele: Po!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. E. Çefa: Atëherë, ndoshta me konkluzionet tuaja, ju mos vallë po kërkonit që në të shpallim..., pra të konstatojmë pavlefshmërinë absolute në fakt të vendimit të Komisionerit? Kjo pastaj do të ishte në logjikën që do të konsiderohej që ky akt nuk ka ekzistuar asnjëherë dhe më pas situata do të ishte siç ishte përpara daljes së këtij vendimi? Apo kërkonit shfuqizimin?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Jo, faleminderit! Për sa i përket mënyrës se si Kodi i Procedurave Administrative shprehet në lidhje me pavlefshmërinë absolute, shfuqizimin dhe anulimin, pothuajse të treja këto dispozita të referojnë te shkelja flagrante e ligjit. Ne i bëjmë me dije KAS-it shkeljet flagrante të ligjit të cilat të çojnë në pavlefshmërinë absolute, sepse siç edhe ja parashtruar Komisionerit gjatë shqyrtimit administrativ në seancë dëgjimore, Komisioneri ka shkelur rregullat thelbësore që i përkasin kompetencës dhe diskrecionit. Është në vlerësimin tuaj, duke qenë se Kodi i Procedurave Administrative parashikon që “edhe organi që shqyrton ankimin administrativ, ka të drejtë të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit”. Pra, është në vlerësimin tuaj. Pasoja zgjidhet në të njejtën mënyrë si me pavlefshmërinë absolute të aktit dhe me anulimin e tij. Pasi ne me anulimin e këtij akti kërkojmë pikërisht të njejtat pasoja. Pra, konstatimin e vlefshmërisë së këtij vendimi, i cili nuk është kontestuar asnjëherë dhe konstatimin e mungesës së shkaqeve për ndërprerjen e parakohshme të mandatit të shtetasit zotit Dhionisios (Alfred) Beleri. Kjo është arsyeja që i kemi parashtruar të gjitha kërkimet në kërkesë, në mënyrë që t’ju lemë të hapura të gjitha... të ezaurojmë të gjitha kërkimet tona në mënyrë që në procedurat e mëtejshme gjyqësore të kemi konsumuar rrugën administrative, faleminderit!


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. K. Bele: Dëgjojmë përfaqësuesin e KQZ-së në lidhje me çfarë u pretendua nga ankuesi.

Znj. M. Koja: Të nderuar anëtarë të KAS-it, më lejoni të parashtroj si vijon: Zoti Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, është propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, si kandidat për kryetar të Bashkisë Himarë në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Në zbatim të ligjit nr. 138/2015, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi kompetent për administrimin, vlerësimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin për funksionet publike, si dhe përpunimin për formularin e vetëdeklarimit për disa subjekte ndër të cilat është edhe “kryetari i bashkisë”. Në datën 31.03.2023, pranë KQZ nga zoti Beleri ka depozituar formulari e vetëdeklarimit, i cili është regjistruar me numër unik 13387. Në bazë të Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, KQZ-ja bëri verifikimin “prima facie” të të dhënave që përmban ky formular dhe konstatoi se kandidati nuk është në kushtet e ndalimit. Në vijim të këtij konstatimi, KQZ ndërmori hapat proceduralë të komunikimit me zyrën e gjendjes civile pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, nga e cila u informua se subjekti vetëdeklarues rezulton të ketë ndryshuar emrin nga “Alfred” në “Dhionisios”. Gjithashtu bëri verifikimet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, e cila nga ana e saj informon Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se subjekti vetëdeklarues rezulton i rehabilituar. Pasi është konstatuar që kandidati nuk është në kushtet e ndalimit për të kandiduar, janë verifikuar të dhëna të tjera në formularin e vetëdeklarimit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur t’ia kalojë rastin për verifikim të thelluar Prokurorisë së Përgjithshme, si institucioni kompetent që kryen verifikimin e plotë të deklarimeve të bëra. Në përfundim të procesit zgjedhor të vitit 2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 611, datë


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

25.05.2023, i ka dhënë mandatin zotit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, si kryetar i Bashkisë Himarë. Kronologjikisht vazhdojmë me fakte më poshtë, që kanë ndodhur në vijim. Në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve është paraqitur kërkesa me nr. 1719 prot., datë 26.06.2023 nga zoti Eugen Likaj nëpërmjet të cilës kërkohet konstatimi i përfundimit të parakohshëm të mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, zotit Beleri, propozuar nga Koalicioni “Bashkë Fitojmë”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve shkresërisht në datën 27.06.2023 ka kërkuar informacion/dokumentacion Gjykatës të Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, nëse është marrë ndonjë vendim penal në ngarkim të shtetasit Beleri. Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar në datën 1.07.2024, ka dërguar në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shkurtimin e vendimit nr. 26, datë 25.06.2024, dhënë në ngarkim të të pandehurve Pandeli Kokoveshi dhe Dhionisios Petro Beleri. Gjithashtu KQZ në datën 1.07.2024 i ka kërkuar informacion zyrës së gjendjes gjyqësore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në lidhje me këtë shtetas. Në përgjigje të kësaj kërkesë zyra e gjendjes gjyqësore ka dërguar dëshminë e penaltetit, në të cilën pasqyrohet vendimi me nr. 26, datë 25.06.2024 i Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i cila ka lënë në fuqi vendimin nr 14, datë 05.03.2024, të dhënë nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar. Në vijim të këtyre veprimeve administrative, bazuar në nenin 10, pika 1, shkronja “ç”, të ligjit nr. 138/2015, sipas të cilit përcaktohet se “KQZ ...shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas shpalljes së rezultatit të zgjedhjeve, në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe para fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi i shpallur i zgjedhur në kundërshtim me këtë nen, si dhe shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor...”. Ligji për Dekriminalizimin e ndalon një person të kandidojë kur verifikohet që ai/ajo ka kryer një nga veprat penale të

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

listuara në këtë ligj. Bazuar në këtë ligj, një personi i hiqet mandati i fituar (si deputet, kryetar bashkie, anëtarë këshilli bashkiak, apo ministër, jo deputet) kur pas marrjes së këtij mandati, apo pas fillimit të ushtrimit të detyrës, verifikohet se ai/ajo ka kryer një nga veprat penale të listuara nga ligji i dekriminalizimit. Ligji të ndalon të kandidosh nëse individi është në kushtet e kryerjes të dënimit për një vepër penale të caktuar, pra të ndalon edhe të pretendosh për të marrë një funksion publik, logjikisht ligji nuk të lejon që ta mbash këtë funksion publik, pasi e ke marrë atë dhe gjatë ushtrimit të funksionit ti kryen një vepër penale, apo merr një dënim i cili nuk do të lejonte të kandidojë! Pra, nëse për të njëjtin dënim një person nuk mundet të jetë i denjë për të kandiduar, ai nuk është i denjë për të qëndruar në detyrë. Në këtë interpretim logjik të përmbajtjes tërësore të ligjit nr. 138/2015, është marrë dhe vendimi i Komisionerit nr. 69, datë 5.07.2024, nëpërmjet të cilit është vendosur shpallja e pavlefshmërisë dhe përfundimi i parakohshëm i mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë, Qarku Vlorë, zoti Dhionisios (Alfred) Petro Beleri. Faleminderit!

Z. K. Bele: Faleminderit zonja Koja! Vazhdojmë me pyetjet nga kolegët nëse ka?

Z. E. Çefa: Unë kam një pyetje, ose dy më saktë, për administratën. Ligji për dekriminalizimin, saktësisht sipas llogaritjeve të mia, do të ketë hyrë në fuqi rreth fillimit të janarit 2016. Nuk e di, a ka në KQZ ndonjë rast të konstatimit të pavlefshmërisë së mandatit të ndonjë organi të zgjedhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji? A ka pas raste të tilla të ngjashme përpara ligjit të dekriminalizimit? Në qoftë se prezumojmë se nuk ekziston ligji i dekriminalizimit fare dhe na ndodh situata kur një kryetar bashkie dënohet me vendim të formës së prerë, si do të hiqet ky nga detyra, në qoftë se ligji i dekriminalizimit nuk do të ekzistonte?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. P. Doçi: Jemi përpara faktit që ligji ekziston, në rast se nuk do të ekzistonte do të ndiqeshin referenca të tjera ligjore.

Z. E. Çefa: Po pretendohet që nuk është ky ligji aplikueshëm në këtë rast...

Znj. P. Doçi: Po pretendohet nga pala ankuese, ndërkohë është vendimi i ...

Z. E. Çefa: Po pra, unë po ju pyes ju, a ka pas më parë raste kur janë shkarkuar, ose janë ndërprerë mandatet e ndonjë kryetari komune/bashkie?

Znj. P. Doçi: Do duhet ta verifikojmë këtë, nuk kemi ndonjë të dhënë.

Z. E. Çefa: Nuk e kemi! Dakord!

Z. K. Bele: As të ndërprerjes nuk ka pasur...

Znj. P. Doçi: Megjithatë në rast se më lejoni, meqenëse mora fjalën, do të doja të bënim disa kundërshtime lidhur me ankimin e paraqitur nga pala ankuese.

Z. E. Çefa: Po patjetër, ja ta mbaroj... pyetja tjetër në fakt ishte ajo që unë bëra. Në qoftë se nuk do të ishte ligji i dekriminalizimit, në opinionin tuaj si do të ishte zgjidhur ky kauzus? Pra do të ishte mbajtur në detyrë kryetari i bashkisë edhe pse ishte i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë? Apo ka ndonjë mekanizëm tjetër juridik për ta riparuar këtë situatë jo të ligjshëm.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. P. Doçi: Ne jemi përpara kushti dhe përpara fakti që ekziston ligji i dekriminalizimit. Kemi një ligj ku jemi referuar. Në rast se nuk do të kishte përcaktimet, apo kompetencën e përcaktuar në ligjin e dekriminalizimit se kush...

Z. E. Çefa: Dakord e kuptova! Po e riformuloj pyetjen! Në qoftë se ligji i dekriminalizimit nuk do të ishte, a mund të shkarkohej një kryetar bashkie me ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore”?

Znj. P. Doçi: Do të shkarkohej me ligjin 139/2015 sipas procedurës, neni 61, 62 “Për Vetëqeverisjen Vendore”...

Z. E. Çefa: Pra, paska një procedurë alternative për zgjidhjen e këtij problemi, apo jo?

Znj. P. Doçi: Por, aty ka përcaktime të tjera, ka rrethana të tjera, ashtu sikundër pala referohet në nenin 61 dhe pretendon se janë disa rrethana...

Z. E. Çefa: Për çfarë rrethanash të tjera bëni fjalë, ju lutem? Mi specifikoni pak!

Znj. P. Doçi: Po patjetër! Atëhere, pala pretendon se në nenin 61, ka disa rrethana shteruese kur përfundon para kohe mandati i një kryetari të bashkisë dhe janë të listuara: nuk pranon të bëjë betimin, jep dorëheqjen e të tjera, e të tjera. Ndërkohë për të kundërshtuar nenin 61...

Z. E. Çefa: Jo e të tjera, e të tjera, thuaje siç është!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 12.09.2024

Znj. P. Doçi: Po, “kandidon për deputet, humb zotësinë, nuk është më banor i përhershëm i bashkisë..”. T’ua lexoj gjithë nenin?

Z. E. Çefa: “..ose shkarkohet sipas nenit 62”.

Znj. P. Doçi: “..ose shkarkohet sipas nenit 62”.

Z. E. Çefa: Atëherë, kur shkarkohet sipas nenit 62?

Znj. P. Doçi: Tani, ne objekt të këtij gjykimi dhe objekt të këtij vendimi kemi pavlefshmërinë e mandatit të zotit Beleri sipas përcaktimeve të ligjit, nuk jemi këtu për të dhënë...

Z. E. Çefa: Të kujt ligji?

Znj. P. Doçi: Sipas përcaktimeve të ligjit të dekriminalizimit. Jemi referuar në atë ligj.


Z. E. Çefa: Tani, që unë të gjykoj a keni vepruar mirë ju...

Znj. P. Doçi: Unë nuk mund të jap vlerësimin tim personal si juriste, por duke qenë se jam përfaqësuese e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, mund të them që vendimi është marrë pikërisht në referim të atij ligji.

Z. E. Çefa: Të kujt ligji?

Zbardhi materialin audio

Merita DULAKU



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. P. Doçi: Të nenit 10 të ligjit të dekriminalizimit dhe kompetencave...

Z. E. Çefa: Pse jo në referim të ligjit 139, i cili kishte një procedurë të përcaktuar mirë edhe për zgjidhjen e këtij rasti... Pse?

Znj. P. Doçi: Është arësytuar brenda...

Z. E. Çefa: Pse nuk është marrë? Në qoftë se keni dijeni, se ndoshta dhe nuk e dini. Nuk është turp të thoni edhe “nuk e di”.

Znj. P. Doçi: Po, patjetër, edhe mund të mos e di. Mund të bëj dhe interpretimin si juriste, por nuk marr përsipër të shprehem si përfaqësuese e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Unë mendoj se neni 62...

Z. E. Çefa: Është zgjedhje subjektive e Komisionerit, po thoni ju? Ligji i aplikueshëm në këtë rast, pra mund të aplikonte 139, ose ligjin tjetër...

Znj. P. Doçi: Absolutisht! Ne kemi një ligj material në të cilin ne mund të referohemi. Kemi një kod zgjedhor që na detyron që ta përmbushim me saktësi dhe kemi disa ligje të tjera që na detyrojmë të zbatojmë po me saktësi ligjin. Siç e kemi bërë në këtë rast në referim të nenit 10, germa “ç” të ligjit të dekriminalizimit. Në rast se do të bëjmë interpretimin, kur shkarkohet, kur e merr mandatin, kur e ushtron, kur bën betimin... ato janë gjëra që i përkasin një tjetër institucioni.

Z. E. Çefa: Atë keni bërë! Zonjë, dua të kuptoj si e keni bërë? Se ju këtë keni bërë faktikisht. Jo ju, po Komisioneri!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. P. Doçi: E kemi bërë në referim të nenit 10, germa “ç”. Unë po flas si përfaqësuese e Komisionerit. Në referim të këtij ligji, mendoj se jemi organi kompetent për të nxjerrë këtë akt. Pala ankuese pretendon se nuk jemi kompetentë për të nxjerrë këtë akt. Ndërkohë ne e kundërshtojmë dhe me bazën ligjore të vendosur në vendim që jemi kompetentë për të shpallur pavlefshmërinë e mandatit sipas nenit 10 të ligjit të dekriminalizimit nr. 138/2015. Përpara se të shkojmë këtu, mendoj se ankimi ka një mangësi të theksuar në lidhje me ...

Z. E. Çefa: Edhe një pyetje tjetër! Pika “ç” e nenit 10 që ju e keni përdorur si bazë ligjore thotë: “kur verifikohen kushtet për moskandidim dhe moszgjedhje në përputhje me këtë ligj, KQZ-ja kryen veprimet e mëposhtëme...” dhe është pika “ç” “shpall pavlefshmërinë e mandatit”. Ndërkohë që Komisioneri ka shkuar përtej dispozitës. Pra, përveç se ka shpall pavlefshmërinë e mandatit, ka thënë dhe ndërprerjen e parakohshme të mandatit, që në fakt nuk parashikohet në këtë dispozitë. Pse ka zgjedhur Komisioneri këtë lloj dispozitivi, për t’u shprehur në këtë mënyrë? Gjithmonë nese mund të përgjigjeni! Praktikisht ka marrë një vendim të dyanshëm. Ka përdorur dy arësytetime paralele, dy konkluzione paralele për të njejtën gjë. Tani ose është pavlefshmeri e mandatit, ose është ndërprerje e parakohshme e mandatit.

Znj. P. Doçaj: Atëherë, ligji dhe neni i aplikuar dhe shkronja e saktë e aplikuar është ligji 138/2015, neni 10, pika “ç”.

Z. E. Çefa: Po! Atë lexova dhe unë.

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 12.09.2024

Znj. P. Doçaj: Në të gjithë arësytimin e vendimit dhe në bazë ligjore është vendosur ky nen. Për sa i përket pjesës së dytë të pikës së parë të dispozitivit, ku ka të bëjë me ndërprerjen e mandatit, nuk është se ne nuk jemi kompetentë për ta bërë këtë. Në rast se shkojmë tek germa “d”, pra, jo te “ç”, te germa “d”...

Z. E. Çefa: Po pse nuk e keni përmendur edhe germën “d” në bazë ligjore?

Znj. P. Doçaj: Nuk e kemi përmendur, sepse nuk jemi në ato kushte, por nuk mund të mos jemi kompetentë...


Z. E. Çefa: Atëherë, përse e keni aplikuar kur nuk jeni në ato kushte?

Znj. P. Doçaj: Në rast se do të ndodhte kushti i germës “d”, ne do të ishim kompetentë për ta bërë edhe atë, për ta ndërprerë edhe mandatin.

Z. E. Çefa: Po e keni ndërprerë pra, se dhe në vendim e ka ndërprerë Komisioneri. Edhe e ka konstatuar të pavlefshëm dhe e ka ndërprerë.

Znj. P. Doçaj: Ne i kemi dhënë një vendim për dhënien e mandatit të kryetarit të Bashkisë Himarë. Ja kemi dhënë këtë mandat? Deri këtu jemi në rregull! Ja kemi dhënë. Ne jemi shprehur vetëm në funksion të atij mandati që ne ia kemi dhënë me vendim, jo për shkak të ushtrimit të detyrës së tij, por për shkak të atij mandati që ne i kemi dhënë formalisht. Pra, kemi një vendim që i japim një mandat. Vetëm për këtë pjesë, ndërsa për sa i takon për të qenë më korrekt, kemi aplikuar nenin 10, pika “ç”. Jemi në këto kushte.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. E. Çefa: Edhe një pyetje tjetër! Pse i thoni ju, ose pse në opinionin tuaj, ose të Komisionerit nëse keni dijeni, nuk ka vend për t'u aplikuar në këtë rast ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore"? Pse nuk duhej të pritej që procedura për shkarkimin nga detyra të ankimuesit në këtë rast, të bëhej sipas një ligji shumë më të hershëm?

Znj. P. Doçaj: Pse të bëhej sipas atij ligji e të mos bëhej përpara këtij ligji që janë të dy ligje të barazvlefshme. Janë të miratuara me 3/5, janë ligje kushtetuese...

Z. E. Çefa: Pse janë të barazvlefshme këto dy ligje, ata rregullojnë dy gjëra krejt të ndryshme?

Znj. P. Doçaj: Ata janë krejt njësoj...

Z. E. Çefa: Jo, nuk janë njësoj. Ata rregullojnë dy gjëra krejt të ndryshme...

Znj. P. Doçaj: Jo, absolutisht. Pse të mos referohemi tek ligji specifik...

Z. E. Çefa: Po të ishin njësoj, s'kishim nevojë me miratuar këtë tjetrin.

Znj. P. Doçaj: Jo, jo, po flas për shkak të hierarkisë së ligjit. Pra, po flas për faktin që ligji i dekriminalizimit është ligj ku ne bazohemi për ushtrimin e veprimtarisë së institucionit, për kryerjen e funksionit që ne kemi.

Z. E. Çefa: Dakord! Nuk e mora pyetjen tamam siç e desha, por e kam të qartë dhe pozitën tuaj, faleminderit!

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. L. Braho: Kam unë një pyetje!

Z. K. Bele: Më fal Ledio! Në rast se përfaqësuesja e KQZ-së ka për të thënë disa gjëra në mbështetje të prapësimeve të tyre, të mos e bëjmë ...

Z. L. Braho: Ky thelbi i ligjit është, megjithatë...

Z. K. Bele: Ti dëgjojmë çfarë ata kanë për të thënë për ankimin, në mënyrë që të ezaurojmë pyetjet për çfarë qëndrimi mban KQZ-ja në lidhje me seancën. Besoj është më korrekte.

Znj. P. Doçaj: Duke qenë se ne kemi mbajtur disa shënime në lidhje me kundërshtimet...

Z. K. Bele: Po!

Znj. P. Doçaj: I kemi kapur një pas një me rradhë, duke qenë se pala ankuese ka një paqëndrueshmëri, të themi. Ka shumë material të cilat përsëriten etj., etj.. Ne kemi mbajtur ato pikat kryesore ku ne...


Z. K. Bele: Ju jepni arësyen tuaj, pastaj qëllimi është...

Znj. P. Doçaj: Mendojmë se së pari, vlerësojmë se shkaqet e ankimit nuk qëndrojnë, pasi mbetet e paqartë se ku referohet pala pretenduese. Pra, ka një akt absolutisht të pavlefshëm, apo kemi të bëjmë me një pavlefshmëri, apo një paligjshmëri të aktit. Këto janë disa kritere që Kodi i Procedurës Civile enkas i ka ndarë nën 108, 109 e

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

vijues ku përcaktohen në mënyrë shterruese të gjitha kriteret që duhet të ketë një akt administrativ. Pra, së pari nuk na ka sqaruar në ankim se ku përqëndrohet dhe çfarë duhet të zbatohet pra, KAS. Pra, duhet të kërkojë pavlefshmërinë e aktit, apo të kërkojë paligjshmërinë e aktit? Se dyti, lidhur me kompetencën që është dhe më e rëndësishmja, e ka kundërshtuar. Ne mendojmë që nuk qëndrojnë pretendimet e tyre, pasi në nenin 10 përcaktohet në mënyrë taksative se kush është kompetente për të shpallur pavlefshmërinë e mandatit. Po ashtu dhe përfundimin e parakohëshëm të mandatit, në rast se do t'i qëndronim pikës “d” të këtij ligji. Për sa i përket procedurës administrative. Pala pretendon se fillimi i procedurës administrative për të shpallur pavlefshmërinë e mandatit të zotit Beleri ka filluar e iniciuar nga një individ. Në fakt, në qoftë se do të shohim në mënyrë të detajuar vendimin do të kuptojmë që nuk ka të shprehur në asnjë pjesë, as në bazë ligjore, por as në arësyetim faktin se procedura administrative ka filluar me inicimin e kërkesës së një individi, për të shpallur pavlefshmërinë e mandatit. Referojmë nenin 41, pika “b” Kodi i Procedurës Administrative. Ne jemi referuar pikërisht këtu, kur kemi filluar procedurën kryesisht. Është në diskrecion të organit publik kur është i detyruar ta fillojë këtë procedure kryesisht. Fakti është i njohur botërisht edhe në referim të Kodit Zgjedhor për një fakt të njohur botërisht, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mund të fillojë një procedurë administrative edhe pa kryer verifikime. Pra kemi dy nene të cilat ne mbështetemi. Nrni 41, pika “b” e Kodit të Procedurës Administrative dhe 139 e Kodit Zgjedhor. Për këtë motiv, mendojmë se nuk qëndron edhe pretendimi që procedura paska iniciuar jo kryesisht, por me indicie nga palë të treta. Po kështu kemi respektuar edhe neni 42 të Kodit të Procedurës Administrative në lidhje me procedurën e njoftimit, sepse pala pretendon se nuk është kryer njoftimi në formën e duhur. Ndërkohë ne e kemi kryer sipas Kodit Zgjedhor, sipas nenit 42 dhe për më tepër sipas rregullores së KQZ-së. Fillimisht i kemi dërguar procesverbalin

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

nëpërmjet email-it, kemi njoftuar palët për takimin që është seanca publike. Eshte kërkuar dokumentacion shtesë, kanë sjellë gjatë këtij takimi palët, dokumentacion shtesë. Pra është kryer e gjithë procedura administrative e përcaktuar në ligj. Pala pretendon se mungojne elementet e aktit administrativ. Nuk qëndron as ky pretendim, pasi ky akt ka çdo element të një akti administrativ vendimi i Komisionerit. Ka formen, ka përmbajtjejn, bazën ligjore, arsyetimin dhe të gjithë elementët që e përbëjnë një akt administrativ të vlefshëm në referim të ligjit. Pala pretendon gjithashtu se KQZ verifikon vetem formularin e vetëdeklarimit. Në të vërtetë KQZ nuk merret vetëm me verifikimin e formularit të vetëdeklarimit por ka dhe kompetenca të tjera të cilat vetë ligji i dekriminalizimit ja detyron ato. Pra, duhet të kryej verifikimet pranë Drejtorisë së Burgjeve, gjendjes civile. Të kryejë verifikime të thelluara në rast se konstaton moszgjedhshmëri, shkarkim, dmth të gjitha këto bëjnë që KQZ të ketë dhe kompetenca të tjera nga ato që pala pretendon. Nenin 61, mendoj se e ezaurova, sepse pala ankuese pretendon që neni 61... janë shteruese rastet kur mund të shkarkohet një kryetar, ndërkohë po t'i referohemi nenit 2 dhe 10 të ligjit 138/2015, ekzistojnë rrethana të tjera të ndryshme nga ato të ligjit 139 të cilat kur verifikohen, passjellin shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit. Në lidhje me parimin e diskrecionit, pala pretendon që KQZ e ka shkel edhe këtë parim, gjë e cila nuk është e vërtetë pasi KQZ nuk i ka kaluar në asnjë moment atë kufirin që i ka përcaktuar ligji. Së fundi, në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar. Pala pretendon se vendimi i dhënies së mandatit të kryetarit të bashkisë ka marrë formë të prerë, pasi nuk është i ankimuar. Duke qenë se ka marrë formë të prerë jemi përpara një vendimi të gjykuar tashmë. Nuk qëndron dhe ky pretendim. Objekti i të dy vendimeve është i ndryshëm. Rrethanat dhe baza ligjore është e ndryshme. Për këtë motiv nuk jemi para kushteve të cënimit të parimit të gjësë të gjykuar. Vlerësojmë se organi, normalisht ai që jep mandatin edhe e heq. Kështu që për këtë

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

motiv, në tërësi të gjithë këtyre që ne thamë, akti i nxjerrë është brenda kompetences, konform procedurës, në respektim të formës së aktit administrativ dhe në përputhje me ligjin material. Për këtë motiv, nuk duhet të pranohet ankimi dhe të lihet në fuqi vendimi i Komisionerit.

K. Bele: Mirë, faleminderit! Zoti Braho!

Z. L. Braho: Atëherë, ligji material, ju e pranuat dhe vetë që ka dy ligje materialë që janë të zbatueshëm në këtë rast. Ajo që kishte për detyrë të bënte Komisioneri ishte të përcaktonte se kush është ligj material më i posaçëm për këtë rast. Tani nenin 41 të Kodit të Procedurës Administrative që dëgjova këtu, ka të bëjë me situata faktike. Kjo nuk është situatë faktike, kjo është situatë ligjore nuk është faktike. Situata faktike është tjetër, se kjo e lidh edhe me mbrojtjen e interesit publik etj., etj., Për mua kjo është situatë ligjore. Megjithatë ajo që është më tepër e diskutueshme ka të bëjë me nenin 10 që është aplikuar. Neni 10, pika 1, shkronja “ç”, që ka të bëjë me shpalljen e pavlefshërisë. Ajo që pretendon pala ankuese dhe që është e debatueshme në këtë rast është që, a mundet që të aplikohet ligji për dekriminalizimin për një vendim që nuk mundet në momentin e dorëzimit të formularit të dekriminalizimit të parashikohej, sepse zoti Beleri ose kushdo yjetër nuk e di se çfarë ndodh në të ardhmen. Pra, formulari i vetëdeklarimit, ka të bëjë me atë që ka ndodhur nga dita e deklarimit e më parë. Verifikimi, kur flitet për verifikim, të gjitha këto pikat që janë te neni 10, kanë të bëjnë me momentin e verifikimit, jo me momentin e ndodhjes së çështjes siç ka ndodhur në rastin e zotit Beleri. Pra, kur verifikohet dhe verifikimi mund të vijë në momente të ndryshme për arsye të ndryshme, sepse nuk është deklaruar në formular vetëdeklarimi, në një moment të caktuar këto organe, apo persona që kanë të drejtë që të bëjnë kërkesë për verifikime,

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

e bëjnë në një moment të mëvonshëm? Në këtë rast nuk jemi në asnjë nga këto kushte, sepse realisht ajo që ka ndodhur është një vendim që ishte pas formularit të vetëdeklarimit. Tani pyetja që kam unë, formulari i vetëdeklarimit dorëzohet vetëm në momentin e kandidimit, apo këta kryetarët e bashkive në detyrë sa herë që i ndodh diçka sjellin një formular vetëdeklarimi këtu në KQZ?

Znj. P. Doçi: Po nis fillimisht me nenin 41, duke qenë se u përmend në lidhje me faktin që situatat janë faktike dhe është organi ai që duhet të fillojë procedurën administrative për mbrojtjen e një interesi publik. Nuk ka interes publik më të madh se qëllimi i vetë ligjit, “për garantimin dhe funksionimin e organeve të zgjedhura”. Ky është interes publik. Po të shihet qëllimi i ligjit është enkas i përdorur. Pikërisht qëllimi i këtij ligji është të garantojë besimin e publikut në funksionimin e organeve të zgjedhura shtetërore, institucione të pavarura, apo atyre që krijojnë me ligj të administratës etj., etj.. Pra, qëllimi i ligjit e ezauron tërësisht mbrojtjen e interesit publik dhe jemi pikërisht te kjo pikë.

Z. L. Braho: A ka qenë i besueshëm për publikun zoti Beleri, kur u verifikua një herë formulari i vetëdeklarimit të tij?

Znj. P. Doçi: Në momentin që është verifikuar formulari i vetëdeklarimit, ka pas të deklaruar disa të dhëna, të cilat janë verifikuar nga ana jonë dhe janë çuar për verifikim të thelluar në Prokurorinë e Përgjithshme. Kjo procedurë administrative nga ana e prokurorisë nuk ka përfunduar, nuk kemi akoma një përgjigje. Në rast se do të na vinte sot, patjetër që do të na vinte me vendimin gjyqësor të formës së prerë...

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. L. Braho: Ju nuk ia keni ndërprerë mandatin për ç'ka kishte ndodhur në të shkuarën! Ju ia keni ndërprerë mandatin për diçka që ka ndodhur faktikisht pas zgjedhjes së tij.

Znj. P. Doçaj: Është një fakt i cili ekziston edhe nëse do të kandidonte sot, nuk do të mund të kandidonte, as sot, as pas 20 vjetësh, sepse e ka të ndaluar për shkak të dënimit.

Z. L. Braho: Çfarë ka ndodhur sot është tjetër gjë, ne po flasim... *(nuk dëgjohet mirë)*

Znj. P. Doçaj: Patjetër, është zgjedhur. Ai nuk mund të zgjidhet dhe jo më të qëndrojë në funksion. Ky është interpretimi dhe fryma e ligjit. Këtë kemi përdorur si arësyetim, ky është...

Z. L. Braho: Në qoftë se një deputet i Kuvendit të Shqipërisë dënohet sot. Është kompetencë e Komisionerit për t'ia ndërprerë mandatin, apo e Komisionit të Mandateve në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë? Është i njëjti kauzus!

Znj. P. Doçaj: Ja ta lexojmë njëherë!

Z. I. Rusmali: Të bëj nja dy pyetje?

Z. K. Bele: Po!

Z. I. Rusmali: Meqenëse jemi ende në këtë diskutim të ligjit dhe të zbatimit të tij. Ndoshta ju e keni informacionin, në qoftë se e keni. Në praktikën e KQZ-së, ka pasur

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

raste të tjera shqyrtimi të mandatit, pa relacionin e Prokurorirë së Përgjithshme? Pa ardhur sugjerimi nga Prokuroria e Përgjithshme se jemi në kushtet e ndalimit? Apo në të gjitha rastet që ju keni shqyrtuar më parë të ngjashme, kanë pas si fillesë të procedurës, relacionin e Prokurorisë së Përgjithshme? Në qoftë se ju jeni në dijëni.

Z. K. Bele: Edhe unë do të kisha të njejtin interes, se në kujtesën tonë dhe para se të funksiononte ky organ, ka pas disa raste ndërprerje mandatesh deputetësh, besoj dhe kryetarë bashkie.

Znj. P. Doçaj: Në rast se është me interes, ne mund të kërkojmë, nëse na lihet një kohë.


Z. I. Rusmali: Dakord! Pyetja e dytë, unë ju dëgjova që folët për kompetencën dhe nuk dua të rikthehem te kompetenca. Pretendimi i ankuesit është që ky shqyrtim është bërë sipas një procedure ekstra ligjore. Ankuesi thotë që “nuk ka dispozitë proceduriale që t’ju autorizojë ju të bëni këto veprime”. Keni një përgjigje për këtë?

Znj. P. Doçaj: Po! Siç edhe e citova, në referim të ligjit të dekriminalizimit, ne jemi kompetentë për shkak të ligjit...

Z. I. Rusmali: Mos më fol për kompetencën!

Znj. P. Doçaj:... dhe kemi aplikuar në zhvillimin e procedurës administrative, Kodin e Procedurës Administrative dhe Kodin Zgjedhor. Pra, në rast se ne flasim për procedurë administrative i kemi qëndruar strikt ligjit dhe në rast se flasim për kompetencë mendojmë se i kemi qëndruar strikt po ligjit tjetër pra, 138. Kështu që

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

në përmbushje dhe zbatim të të dy ligjeve, mendoj se jemi kompetentë. KQZ e ka kompetencën për të nxjerrë aktin administrativ dhe për të vendosur pavlefshmërinë e mandatit të zotit Beleri, sikurse dhe ia ka dhënë. Përderisa ia ka dhënë edhe mundet t'ia...

Z. I. Rusmali: Dakord! Kompetenca, por jo kompetencën. Dua procedurën!


Znj. P. Doçaj: Nuk ka një procedurë ekstra ligjore ne fakt. Është një fakt i njohur botërisht. Pas konstatimit të këtij fakti, jemi vendosur në lëvizje ashtu siç e keni dhe në dispozicion në dosje. Kemi disa shkresa për të cilën ne kemi bërë një hetim administrativ ku i jemi drejtuar SPAK-ut për të vërtetuar këtë faktin e njohur botërisht dhe na ka vënë në dispozicion një shkurtim vendimi ku përcaktohet qartë dënimi i formës së prerë.

Z. I. Rusmali: Dakord!

Znj. P. Doçaj: Po kështu dhe shkresat drejtuar institucioneve të tjera siç është ajo e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku...

Z. I. Rusmali: Kuptova! Çështja është në qoftë se i referohemi ligjit të dekriminalizimit dhe vendimit të kuvendit në zbatim të ligjit të dekriminalizimit. Në qoftë se lexohen ato, krijohet përshtypja që procedura ka rrjedhë kronologjike, hapi i parë, hapi i dytë, hapi i tretë..., hapi i pestë. Dhe thotë “hapi i parë bëhet nga KQZ-ja”, “hapi i tretë bëhet nga prokuroria”, “hapi i pestë bëhet...” nuk e di nga kuvendi. Nuk ka rëndësi, sepse thjesht po e marr për shembull, jo për referencë. Pretendimi është që në këtë rrjedhë hapash veprimi, praktika juaj, shqyrtimi, procedura juaj nuk

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

është e përfshirë. Nuk është në asnjërën nga këto hapa kronologjikë. Ju si e keni parë? Jeni vënë në lëvizje, po në këtë listën e hapave, ku u futët? U futët tek i treti? Tek i pesti?

Znj. P. Doçaj: Nëse shkojmë te neni 10, që në krye të herës janë të përcaktuara veprimet që bën KQZ-ja. Kur e refuzon mandatin. Kur e heq mandatin. Kur shpall kushtet e moskandidimit. Kur shpall kushtet e pavlefshmërisë dhe me rradhë. Pika ku ne jemi referuar është pikërisht “Shpall pavlefshmërinë e mandatit, kur kushtet verifikohen pas shpalljes së rezultatit dhe para ushtrimit të funksionit, pra të detyrës”. Pra “ç” thotë.., siç është “d” më poshtë “shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit”. Këtu “kur fillon ushtrimin...”. Pra, jemi në kushtet kur ky nuk e ka filluar ushtrimin e mandatit dhe për rrjedhojë, ne jemi referuar pikërisht në zbatim të kësaj dispozite. Pra, “shpall pavlefshmërinë e mandatit kur kushtet verifikohen pasi janë shpallur rezultatet, por para ushtrimit të funksionit/detyrës së...”. ndërkohë “d” është e kundërta “shpall pavlefshmërinë e mandatit, por kur ai e ushtron...”. Ne mendojmë se në tërësi të ligjit dhe në frymën e tij, por dhe dispozita e përcaktuar taksativisht në...

Z. I. Rusmali: Dakord! Në tekstin e ligjit të dekriminalizimit që kemi ne përpara. Unë besoj se ky është teksti zyrtar, nuk dua ta vë në dyshim, por ndonjëherë tek ne ndodh që te tekstet ligjore ka dhe lapsuse, ka difekte shtypi e ku di unë me rradhë. Duke lexuar këtë shkronjën “ç” që ju referoni vazhdimisht, kuptohet që Komisionerit i njihen dy kompetenca. Kjo shkronjë i njeh dy kompetenca. Njeh kompetencën për shpalljen e pavlefshmërisë së mandatit dhe lexojeni fjalinë deri tek presja, si dhe thuhet në tekst “shpall mandatin”. Këtu duket sikur ka një “omision”, mungon diçka. Shpall mandatin, çfarë e “shpall mandatin”? E shpall të mirë? E shpall të keq? E

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

shpall gjysmak? Shpall mandatin, në përputhje me Kodin Zgjedhor. Çfarë i bën mandatin? Si e shpall? Ju e keni lexuar dhe e keni konstatuar “omision” dhe e keni plotësuar me pjesën e dytë të fjalisë së dispozitivit, apo si është..., si keni dalë nga ky qorrsoak?

Znj. P. Doçaj: Për interpretim të ...

Z. I. Rusmali: Gjithmonë nëse është i saktë teksti, se mund të jetë teksti me difekt. Ligjvënësi ka qenë në rregull.

Znj. P. Doçaj: Me sa di unë ka dhe te “d” të njejtën “shpall mandatin..”, e ka dhe tek “d”. Nuk e di nëse e është gabim, apo është “copy-paste” . Në interpretim të kësaj, ne pikërisht...


Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Mbase duhet interpretim nga ata që kanë qenë deputetë në atë kohë...

Z. I. Rusmali: Ja, zoti Dule mund të na ndihmojë, se ka qenë deputet në atë kohë. Na ndihmon besoj zoti Dule.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Nuk e di, se interpretimin zyrtar dhe institucional e bën organi që e ka nxjerrë.

Z. I. Rusmali: E dashur avokate! Interpretimin e ligjit e bën organi që e zbaton, se ai është i detyruar ta zbatojë. Pastaj se ç’bëjnë të tjerët është histori tjetër, por të mos merremi tani me teori juridike. Po merremi me një gjë që është shumë konkrete.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Kemi një fjali e cila ka rëndësi për dispozitivin e këtij vendimi dhe kjo fjali këtu në këtë rast, në këtë tekst që ne kemi në dorë, ka një mangësi. Në tekstin e botuar në Fletoren Zyrtare mund të mos e ketë fare mangësinë, gjithshka mund të jetë në rregull. Në rast se e ka këtë mangësi edhe në tekstin e Fletores Zyrtare, këta në rregull, kanë të drejtë ta plotësojnë mangësinë, po me leximin e tyre. Ai mund të thotë që unë e lexoj në këtë formë dhe mund të thotë se e lexoj.., si ishte fjalia në vendim? “... pasi shpall pavlefshmërinë si dhe ndërprerjen e parakohshme”. E ka lexuar kështu! I ka bërë një shpallje të dytë! Ndërprerje..

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Me falni të lutem!

Z. I. Rusmali: Jo të lutem!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Ju po i thoni atyre çfarë të thonë?

Z. I. Rusmali: Jo, jo, jo!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Se nuk e kuptova!

Z. I. Rusmali: Unë po them një gjë, të lutem, që ti nuk po e kupton!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Jo nuk e kuptova, se ju sapo thatë...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. I. Rusmali: Kur të mbaroj unë, mund të flisni ju! E keni kuptuar kështu? Apo duhet kuptuar në një formë tjetër dhe jeni e ftuar edhe ju të na thoni që kuptoni, por ju nuk e keni thënë në kërkesën tuaj ankimore. Jeni të ftuar edhe ju ta thoni, si duhet ta kuptojmë këtë togfjalëshin “...si dhe shpall mandatin”.

Znj. P. Doçaj: Nuk e di nëse ka qenë e vëmendshme avokatia, por unë e kam thënë që në krye të herës. Pra, kemi shpallur pavlefshmërinë e mandatit dhe kemi cituar në pjesën e dytë përfundimin e parakohshëm të mandatit, meqenëse ne ia kemi dhënë këtë mandat, pavarësisht se ai nuk e ka ushtruar atë. Nuk e ka vënë në funksion atë. Këtë e thashë në krye të herës, nuk është çështje sugjerimi. Ne e kemi lexuar në këtë kontekst pavlefshmërinë e mandatit. Të atij mandati që ne ia kemi dhënë me një vendim dhe konstatimin e përfundimit të parakohshëm, sepse normalisht e mbyll përpara periudhës së katërvjeçarit. Kështu që e thashë që në krye të herës dhe ne e kemi lexuar pikërisht kështu. Shpallim pavlefshmërinë dhe mendojmë që e përfundon para kohe. Kështu është lexuar dhe kështu e thashë që në krye të herës.

Z. L. Braho: Në rastin e zotit Beleri qëllon që ai nuk e kishte nisur ushtrimin e mandatit dhe ju jeni kapur me shkronjën “ç”. Të supozojmë që zoti Beleri do të kishte nisur ushtrimin e mandatit, Kush do të ishte organi kompetent, do të ishit ju me shkronjën “d”, apo do të ishte Kryeministri me ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore”?

Znj. P. Doçaj: Ne jemi në kushtet që po shqyrtojmë pikën “ç”. Në rast se mund të ndodhë, do të ndodhë, ka ndodhur, po ndodh...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. L. Braho: Tani, a po bëjmë interpretim? Se po bëjmë interpretim, nuk mund të ngecim pas shkronjës. Shronja “ç” me “d” ndryshojnë vetëm nga... supozohet një kryetar bashkie, dënohet sot. nëse dënohet sot një kryetar bashkie me vendim të formës së prerë...

Znj. P. Doçaj: Do ta arësyetojmë në momentin që do të na vijë. Ne në rast se...

Z. L. Braho: Nuk mund ta thuash pra, se ti e ke arësyetuar, e ke mbajtur qëndrimin.

Znj. P. Doçaj: Pikërisht, sepse i kemi qëndruar strikt kësaj.

Z. L. Braho: Nuk mund të thuash tani “meqenëse ai e ka marrë detyrën, unë nuk zbatoj pikën “d”, por po ia le Kryeministrit ta bëjë me ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore”!


Znj. P. Doçaj: Po ta lexojmë shkronjën “d” pastaj...

Z. L. Braho: Çfarë ndryshimi ka “d” nga “ç”?

Znj. P. Doçaj: Shpall pavlefshmërinë e mandatit dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit kur kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit nga personi përkatës.

Z. L. Braho: Ndaj po them unë, ka të bëjë me verifikimin me vonesë për 100 arësye, apo ka të bëjë se fakti ndodh në momentin që ai e ka nisur ushtrimin e mandatit.

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. P. Doçaj: Në interpretim të pikës “ç”, “d” dhe në interpretim të nenit 10...

Z. L. Braho: Dhe pikës 1 të ligjit...

Znj. P. Doçaj: Po dhe nenit 1 të qëllimit të ligjit, jemi në kushtet kur një kandidat në rast se nuk është në kushtet për t’u zgjedhur, nuk mund ta ushtrojë atë funksion edhe pasi është zgjedhur.

Z. L. Braho: Kushtet për t’u zgjedhur janë në momentin e zgjedhjes, apo gjatë gjithë jetës?


Znj. P. Doçaj: Organi kompetent është KQZ-ja në momentin që konstaton faktin e moszgjedhshmërisë.

Z. L. Braho: Kur është.., pra mund të mos jem unë sot i moszgjedhshëm, për shkak të një ngjarje që mund të ndoshë pas tre vjetësh?

Znj. P. Doçaj: Verifikohet në momentin kur një vendim merr formë të prerë siç e ka të përcaktuar dhe Kushtetuta, neni 45 që e ka të përcaktuar edhe ligji i “Vetëqeverisjes Vendore”.

Z. E. Lako: Kam dhe unë për palën ankuese. Meqenëse ne po bëjmë gjithë këtë debat. Këtu është përqëndruar debati te pjesa e organit kompetent që duhet të nxirrte aktin, sepse përfundimi pak a shumë ky do të ishte në fund. Personi ishte i ndaluar për ta ushtruar detyrën për shkak të ligjit. Pra, ne po merremi më shumë me procedurën e ndjekur dhe me ligjin e aplikueshëm. Të marrim rivers, nëse do të ishte

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*


i aplikueshëm ligji tjetër, ai që ka qenë përpara daljes së ligjit për dekriminalizimin. Sipas jush cili është neni që do të aplikohet në këtë rast nga ajo procedurë që ju ndoqët po ta kishte marrë Këshilli i Ministrave shkarkimin e me rradhë. Cili do të ishte neni përkatës që do të kishte të bënte me këtë procedurë. Pra, të marrim rastin tjetër tani, analog.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Në fakt pyetja juaj nuk i përshtatet faktit, sepse në rastin konkret, zotit Beleri iu dha mandati, por nuk u lejua., iu dha mandati nga populli në fakt. KQZ-ja lexon vendimin e popullit. Nuk është se ia dha KQZ-ja mandatin dhe KQZ-ja ta merr mandatin. Është populli që ta jep mandatin, populli ta merr mandatin...

Z. E. Lako: Më fal, nuk e kam fare aty, e kam në procedurën që do të ndiqet.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Vetëm gjykata flet në emër të popullit. Përsa i përket, në rast se nuk do të ekzistonte ligji i dekriminalizimi, përsëri do të ishim në këtë situatë. Për arsye se zoti Beleri nuk u lejua të bënte betimin. Duhet të ishte pritur të dilte nga burgu, të shkonte të bënte betimin, meqenëse gjatë burgut nuk lejohej, vetëm për të bërë betimin të shkonte në Bashkinë Himarë. Shkoi në gjyqe për shpifje, për fyerje, me çdo gazetar shtatë herë, tetë herë, për të bërë betimin nuk lejohej nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sepse pengonte hetimin penal. Normalisht procedura është e qartë në ligj. Personi zgjidhet nga populli, KQZ-ja lexon vendimin e popullit. Organet e tjera marrin masa për ekzekutimin e vendimit të popullit. Sipas nenit 45 të Kushtetutës, lejohet të betohet, merr mandatin, Këshilli i Ministrave merr vendimin për ndërprerjen e mandatit. Kjo është...

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Z. E. Lako: Këtu jemi. Ku do ta mbështeste Këshilli i Ministrave është pyetja ime. Ajo pjesa më përpara e marrim të mirëqenë ashtu siç e thatë ju.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Kjo është Kushtetuta!

Z. E. Lako: Këshilli i Ministrave, ku do ta mbështeste marrjen e vendimit në rastin e shkarkimit? Në rastin konkret, për këtë shkelje që ne po diskutojmë sot. Cila është mbështetja ligjore që do të kishte Këshilli i Ministrave tek ai ligji “Për Funkcionimin e Organeve të Qeverisjes Vendore”? Kjo është pyetja ime?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Unë jam dakord me ju që ne mund të bëjmë diskutim edhe për të ndriçuar njëri-tjetrin, po problemi qëndron që në rastin ...

Z. E. Lako: Në lidhje me pretendimin tuaj, jo për të ndriçuar...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Pretendimi im nuk ka lidhje fare me këtë pyetje. Pretendimi im ka lidhje që KQZ-ja nuk e ka këtë kompetencë. Pastaj se cilat janë organet e tjera, nuk i përket KQZ-së për ta gjetur.

Z. E. Lako: Jo, unë dëgjova pretendimet tuaja dhe ju thatë në mos gaboj, që “është ndjekur një procedurë gabim. KQZ-ja duhet të ishte organi i fundit që duhet të fliste. Duhet të fillonte nga Këshilli i Ministrave, te Presidenti dhe në fund KQZ-ja”. Tani

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

pyetja shkurt, ku do ta mbështeste Këshilli i Ministrave vendimin për ta shkarkuar nga detyra? Në cilin ligj, në cilin nen, për rastin konkret?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Ju kuptova! Arësyetimi që kam bërë unë në ankim, ka lidhje me faktin që KQZ-ja është shprehur “ndërprerjen e parakohshme të mandatit” dhe në dispozitivin e saj ka marrë dy vendime në të njëjtin akt. Ka vendosur dhe pavlefshmërinë e mandatit dhe ndërprerjen e parakohshme të mandatit. Ndërprerja e parakohshme e mandatit ka një procedurë tjetër që nuk i përket KQZ-së dhe parashikohet në ligjin “Për Qeverisjen Vendore” dhe në Kushtetutë. Ligji “Për Qeverisjen Vendore” parashikon rastet kur ndahen nga jeta, rastet kur dënohen etj..

Z. E. Lako: Për rastin konkret.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Pra, ndërprerja e parakohshme.., unë nuk po i referohem rastit, po i referohem vendimit të KQZ-së. KQZ-ja ka thënë “ndërprerjen e parakohshme të mandatit”. Ku e gjeti KQZ-ja që bëri ndërprerjen e parakohshme të mandatit?

Z. E. Lako: Pra, ju pretendoni që është shprehur gabim KQZ-ja, jo...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Nuk e ka për kompetencë të merret me ndërprerjen e parakohshme të mandatit.

Z. E. Lako: Po kush e ka?

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Këshilli i Ministrave ta shkarkojë!

Z. E. Lako: Ku do ta mbështeste?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që thotë “kur dënohet një kryetar bashkie, Këshilli i Ministrave merr vendim..”.

Z. E. Lako: Ju e dini që Kushtetuta përcakton drejtimet kryesore, ligji është ai që përcakton...


Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Ligji i vetëqeverisjes vendore, neni 62 thotë referuar...

Z. E. Lako: Çfarë thotë?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Kur janë rastet e parashikuara në Kushtetutë.

Z. K. Bele: Nëse më lejon zoti Lako, se jemi në të njejtën pikë. Më fal avokate, se ju e lexuat nenin 62 dhe ne pak, a shumë e kemi të qartë. E lexojmë përsëri. Po këtu, unë desha..., Elvin më fal, kam të njejtën pyetje, por desha të shtoj atë pyetje. Në kemi, në kuptimin tonë dhe në çështje faktike kemi një situatë të veçantë për herë të parë në kujtesën time që një personi i cili ka marrë atë që quhet mandat që ta jep KQZ-ja, por nuk e ka ushtruar atë mandat. Në ligjin “Për Pushtetin Vendor” të vitit

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*


2015, edhe në ligjin e mëparëshëm ka qenë pak a shumë i njejti rregullim, referohet nga norma kushtetuese për mënyrën se si shkarkohet. Tani, pyetja ime! Ne kemi një situatë që flitet për mandat, por kemi dy nënraste, kur e ke marrë mandatin dhe ke përfunduar procedurën dhe e ke ushtruar atë mandat, pra ke filluat ta ushtrosh dhe je bërë kryetar bashkie me tagra të plota dhe në situatën që ne jemi sot. KQZ-ja ka dhënë një mandat, por nuk ka arritur që ky mandat të finalizohet, se ligji përdor fjalën “mandat” në të dyja rastet. Po të shohim nenin 61 thotë “rasti i ndërprerjes së mandatit, refuzimi i betimit..”. Pra, ke marrë mandatin nga KQZ-ja, ke refuzuar të betohesh dhe nuk bëhesh kryetar. Termi “mandat”, ligjvënësi jonë ndoshta i ka rënë shkurt dhe ka përdorur fjalën “mandat”, por qartësisht situatat nuk janë të njejta. Pra kur ke marrë atë quhet mandat i KQZ-së dhe nuk ushtron detyrën dhe të marrësh mandatin në finalizimin e betimit dhe ushtrimin e detyrës. A mendoni se ka një ndryshim midis këtyre dy momenteve nga pikëpamja ligjore? Pra ju, në qoftë se e kuptova, e barazoni situatën e zotit Beleri me çdo kryetar bashkie i cili është në detyrë? Pra, është i njejti mekanizëm thoni ju, duhet të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave, që në momentin që KQZ-ja të deklaron se e ke marrë mandatin?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Faleminderit! Unë mendoj se pyetja juaj është jashtë objektit të gjykimit, së pari, sepse në rastin konkret zoti Beleri nuk e ka ushtruar mandatin.

Z. K. Bele: Këtë po them dhe unë!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Së dyti, nuk është objekt ankimi dhe nuk është objekt vendimmarrje e KQZ-së, nuk ka të drejtë KQZ-ja të zgjidhë situata të cilat ligji nuk ia ka dhënë për të zgjidhur. Mund


*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

të jetë situatë e vështirë për t'u zgjidhur, por kjo nuk i përket KQZ-së, i përket organeve të tjera, sepse kompetencën për të zgjidhur situatat ta jep ligji. sidomos në rastin kur bëhet fjalë për dispozita kushtetuese. Bëhet fjalë për një mandat kushtetues. Është i vetmi mandat që zgjidhet në mënyrë të drejtë për drejtë. Mund të ketë kompetenca të kufizuara, mund të mos ketë kompetenca fare. Është i vetmi rast që sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë që populli ushtron sovranitetin në mënyrë të drejtë për drejtë. Në rast se ne, institucionet, juristët si të doni ju, e kisha në kuptimin e përgjithshëm gjatë këtij debati ta konsiderojmë që mandati i kryetarit të bashkisë i dhënë nga populli, qenka kaq e thjeshtë që të zgjidhet.., po marrim një kompetencë se e ka neni 1, për të zgjidhur një situatë të interesit publik që është perceptuar nga Komisioneri situatë e interesit publik dhe ta zgjidhë, të shpikë situata dhe dispozita “*sui generis*” për të zgjidhur një situatë të tillë, nuk i përket Komisionerit kjo se duhet ta ketë këtë kompetencë Komisioneri. Që të ketë diskrecion, në mënyrë që të shpikë dispozita, të interpretojë në mënyrë të zgjeruar të dispozitave të ligjit 138/2015, i cili është ligj me 3/5 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ketë interpretim të zgjeruar një ligj me 3/5. Mund të ketë vetëm interpretim literal, mund të ketë institucional, por interpretim të zgjeruar nuk mund të ketë një ligj me 3/5. Kështu që Komisioneri nuk mund të shtojë dispozita, as ne nuk mund të shtojmë. Mund të na pëlqejë ta përmirësojmë ligjin. Debate juridike për përmirësimin e ligjit mund të bëjmë gjithë ditën. Një ligj me 3/5 është thajse Kushtetutë, ky ligj interpretohet në mënyrë literale, nuk ka interpretim të zgjeruar, vetëm Gjykata Kushtetuese mund ta bënte. Në rastin konkret, jo vetëm që janë shpikur dispozita, i ka krijuar procedurë, i ka dhënë kompetenca, por e gjithë kjo ndiqet me nenin 1 të ligjit. Ndërkohë neni 1 është qëllimi i ligjit, që është qëllim për të gjithë ne, nuk është qëllim vetëm për Komisionerin. Është për të gjithë institucionet që përfshihen te ligji 138. Në vijim të interpretimit që kërkonte zoti Rusmali, ajo ka të bëjë, pavarësisht

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

se përfshihet për të gjithë subjektet, ka të bëjë me mandatet e këshillit bashkiak, mandatin e deputetit, për të cilin hiqet njëri dhe shpallet mandati për tjetrin. Nuk ka lidhje me “shpall mandatin, shpall pavlefshmëri mandati...”.

Z. I. Rusmali: Që ta kuptoj, “si dhe shpall mandatin vijues..” thoni ju?

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Po, fton atë të listës, i jep mandatin atij të listës. Ky është interpretimi im personal, tërësisht.

Z. I. Rusmali: Dakord! Interpretimi juaj, por ta kuptoj “shpall mandatin vijues”,

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Po shpall mandatin vijues. Në qoftë se pas Belerit në këshillin bashkiak, do ishte Dule, do të thoshte Dule të marrë mandatin. Vazhdon procedura me verifikimin e kandidatit tjetër. Gjithmonë, ky është interpretimi im personal, gjithmonë. Unë i qëndroj strikt interpretimi i ligjeve me 3/5 bëhet në mënyrë literale, gramatikore, për arsye se kanë shprehur vullnetin populli pothuajse, pjesa më e madhe e deputetëve dhe nuk mund të ndikojmë, të ndryshojmë, t’i shtojmë, t’i pakësojmë dispozitat ligjore. Ky është mendimi im. Për sa i përket situatës konkrete, unë mund të jap opinionin tim, por sa vlerë ka opinionin im, për situatën e zotit Beleri?! Sa vlerë ka opinionin i përfaqësueses, sa vlerë ka opinionin i., kur nuk ke një bazë ligjore që të mbështesim këtë opinion dhe t’i japim fuqi, e t’i japim zë opinionit tonë. Se çfarë kemi ne në mendje? Se si mendojmë ne të zgjidhim situatën., ndaj thashë që është jashtë objektit të gjykimit dhe jashtë objektit të vlerësimit në këtë çështje. Se si mund të zgjidhej situata e zotit Beleri. Situata e zotit Beleri, për mendimin tim nuk do të kishte ndodhur fare. Tani ndodhi, ata që e bënë le t’i japin zgjidhje. Nuk e bëri KQZ-

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

ja..., dhe në vijim dhe një kundërshtim të vogël kisha, për sa i përket pretendimeve të përfaqësueses së Komisionerit. Neni 41 nuk është përdorur në vendimmarrje, nuk e ka filluar procedurën kryesisht e ka filluar me ankim të zotit Eugen Likaj. Nga përmbajtja e vendimit kokë e këmbë është Eugen Likaj që ka qenë personi i interesuar dhe në përmbajtje të vendimit, nuk thuhet që e ka filluar procedurën kryesisht sipas nenit 41. Tani, në qoftë se do të shtojmë baza ligjore sot, sipas pretendimeve që parashtrojmë ne, për mua nuk ka rëndësi, se e ka filluar kryesisht, se se ka filluar kryesisht, njësoj se ka atë kompetencë, por nuk e ka në vendim. Sa kohë që nuk e ka në vendim nuk mund ta shtojë.

Z. E. Lako: I kanë çuar shkresat gjykatës dhe ...

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Ajo është procedura. Se si e fillon është tjetër, se si e vazhdon është tjetër. Fillimi...

Z. E. Lako: Por mund ta fillojë dhe kryesisht.

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Mund ta fillojë, por se ka filluar. Ta fillonte kryesisht, të merrte vendim.

Z. I. Rusmali: Nejse, për këtë të dyja palët bënë të qarta leximin e tyre të gjësë është e kotë të bëjmë debat.

Z. K. Bele: Më fal avakote, ju e përmblodhët saktë që debati juridik dhe qëndrimet që mbani ju, apo KQZ-ja për çështje që s'kanë ndodhur mund të jenë pa fund dhe besoj me këtë i dhatë një lloj përgjigjeje dhe pyetjeve të kolegëve ndaj administratës

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve*

Dt. 12.09.2024

së KQZ-së dhe pyetjes time ndaj jush. Mendoj se në këtë fazë i ezauruam pyetjet teorike çfarë mund të bëhej në një situatë, ose çfarë mund të ndodhte në një situatë hipotetike, kështu që e vlerësoj këtë koment si të drejtë nga pikëpamja ime. Nëse nuk ka ndonjë pyetje tjetër nga kolegët.

Z. I. Rusmali: Jo!

Z. K. Bele: Mirë, në këtë fazë jemi te pjesa e kërkimeve përfundimtare. Nuk kemi ndonjë kërkesë për marrje provash. Janë ato aktet e administruara në proces nga KQZ-ja dhe si të tilla. Ju lutem, qëndrimin tuaj përfundimtar për çështjen!

Znj. K. Gjyzari (Përfaqësuese ligjore e zotit Dhionisis (Alfred) Beleri): Atëherë, për të mos u zgjatur, se u zgjata shumë, I qëndrojmë kërkesës ankimore dhe dispozitivit të saj, faleminderit!

Znj. P. Doçaj: Të lihet në fuqi vendimi nr. 69, datë 5.07.2024 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, si i bazuar në ligj e në prova.

Z. K. Bele: Faleminderit! Ne do të mundohemi të jemi racionalë, po tërhiqemi për vendim ndoshta do të rifillojmë për 15 minuta, në rast të kundërt do t'ju njoftojmë për një shtyrje që të mos ju lemë të prisni gjatë. Faleminderit, e ndërpresim seancën!

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike
të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve
Dt. 12.09.2024*

Rifillon seanca

Ora 13:19

Z. K. Bele: Riçelim seancën, në përfundim të shqyrtimit administrativ mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja “b”, të “Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, KAS me shumicë votash, vendosi:

- Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 9, datë 03.08.2024 me ankues Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut.
- Rrëzimin e kërkesës ankimore nr. 10, datë 04.08.2024 me ankues zotit Dhionisios Alfred Beleri.
- Lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 05.07.2024 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë së mandatit të Kryetarit të Bashkisë Himarë, zotit Dhionisios (Alfred) Petro Beleri, propozuar nga subjekti zgjedhor Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
- Bazuar në pikën 1, të nenit 145 të Kodit Zgjedhor, kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, brenda 45 ditëve nga shpallja e tij.

U shpall sot më 12.09.2024

Me kaq seanca deklarohet e mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 20

*Zbardhi materialin audio
Merita DULAKU*

